

Shqipëria

Raporti i vetëvlerësimit, fundi i periudhës

Plani Kombëtar i Veprimit 2016 – 2018

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Kryeministria

Janar, 2019

Lista e shkurtimeve

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AKKISH	Agjencia Kombëtare e Kërkimit dhe Inovacionit Shkencor
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AQTN	Arkivi Qëndror Teknik i Nërtimit
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
GMIP	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave
IDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale
ILDKPI	Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konflikteve të Interesit
KOSCPQH	Koalicioni i organizatave të shoqërisë civile të partneritetit për qeverisje të hapur
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MSHIAP	Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSHÇV	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PHQ	Partneriteti për Qeverisje të Hapur

1. Përmbledhje ekzekutive

Partneriteti për Qeverisjen e Hapur (PQH, ang. OGP) është një ndër instrumentet më të rëndësishme për të nxitur transparencën qeveritare në nivel global, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike dhe për të përdorur teknologjitë e reja për të përmirësuar eficientë administrative dhe luftuar korrupsionin. Shqipëria u bë pjesë e Partneritetit për Qeverisje të Hapur në Shtator 2011, duke dëshmuar përkushtim të vazhdueshëm në mbështetje të vlerave dhe parimeve në themel të kësaj nisme mbarëbotërore.

Gjatë kësaj periudhe janë dakordësuar dhe miratuar Planet Kombëtare të Veprimit 2011-13, 2014-16, 2016-18 dhe 2018-20 që kanë parashikuar angazhime të rëndësishme në adresim të sfidave të PQH-së në vend.

Plani Kombëtar i Veprimit 2011-13 u përgatit nga një Grup Ndërinstitucional Pune (GNP) të ngritur nga qeveria shqiptare për këtë qëllim, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Strategjisë të Antikorrupsionit. GNP udhëhoq nga Ministri për Inovacionin dhe TIK në atë kohë dhe të gjithë anëtarët e saj ishin zyrtarë të nivelit të lartë të ministrive dhe institucioneve publike. Organizatat e shoqërisë civile u përfshinë në procesin e hartimit të PKV-së dhe mediat (ato të shkruara dhe elektronike) ndihmuan në transmetimin e informacionit në kohë për publikun.

Në përfundim të procesit u miratuan 30 angazhime të cilat adresonin tre nga pesë sfidat e mëdha të PQH-së: Rritjen e integritetit publik; Përmirësimin e shërbimeve publike; dhe Menaxhimin më efektiv të burimeve publike;

Plani Kombëtar i Veprimit 2014-16 u përgatit nga një Grup Ndërmintoror Pune (GNP) të ngritur nga Qeveria Shqiptare për këtë qëllim, të përbërë nga zëvendësministrat e çdo ministrie dhe drejtorët e institucioneve dhe agjencive më të rëndësishme publike. Ky proces u udhëhoq nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MSHIAP) në atë kohë dhe u mbështet nga Koalicioni i Organizatave të Shoqërisë Civile për Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

Nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta të GNP-së dhe KOSCPQH u propozuan dhe shqyrtuan projekt-angazhimet për PKV-në 2014-16, prej të cilave një listë prej 25 rekomandimesh kaloi për konsultim publik. Në përfundim të procesit u miratuan 30 angazhime të cilat adresonin katër nga pesë sfidat e mëdha të PQH-së: Rritjen e integritetit publik; Menaxhimin më efektiv të burimeve publike; Përmirësimin e shërbimeve publike; dhe Krijimin e komuniteteve më të sigurt;

Plani Kombëtar i Veprimit 2016-18 u përgatit nga një Grup Ndërmintoror Pune (GNP) të ngritur nga Qeveria Shqiptare për këtë qëllim, nën udhëheqjen e MSHIAP-it, nëpërmjet Forumit të Aktorëve të Interesit/OpenAlb. Forumi OpenAlb siguron një përfaqësim të barabartë të zyrtarëve qeveritarë dhe aktorëve të shoqërisë civile të cilët ishin të angazhuar bashkërisht në procesin e hartimit, konsultimeve dhe vlerësimeve periodike të rezultateve të arritura për angazhimet e Planit Kombëtar të Veprimit.

Nëpërmjet aktiviteteve të OpenAlb-it u propozuan dhe shqyrtuan projekt-angazhimet për PKV-në 2016-18, prej të cilave një listë prej 42 rekomandimesh kaloi për konsultim publik. Në përfundim të procesit u miratuan 17 angazhime të cilat adresonin pesë sfidat e mëdha të identifikuara nga PQH: Rritjen e integritetit publik; Menaxhimin më efektiv të burimeve publike;

Përmirësimin e shërbimeve publike; Krijimin e komuniteteve më të sigurta; Rritja e përgjegjshmërisë së Korporatave.

Më poshtë janë cituar angazhimet e Plani Kombëtar i Veprimit 2016-18:

SFIDAT E MËDHA PQH					
Angazhimi	Rritja e integritetit publik	Menaxhim më efektiv të burimeve publike	Përmirësimi i shërbimeve publike	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i komuniteteve të sigurta
Përmirësimi i portalit me të dhënat e koordinatorëve të të drejtës për informim si dhe programeve të transparencës	X				
Transparenca buxhetore	X	X			
Regjistri i integruar të banesave të shtetasve		X	X		X
Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike			X		
Arkiva digjitale		X	X		
Krijimi i një baze të dhënash për arkivimin dhe publikimin e	X	X			

fondeve dhe programeve për kërkimin shkencor në Shqipëri					
Angazhim për të publikuar online ne sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacionin qendror dhe vendor	X			X	
Angazhim për Standarte Open Contracting, publikim në formatin Open Data të kontratave publike	X				
Zbatimi i Ligjit “Për mbrojtjen e Sinjalizuesve”, ngritje kapacitetesh dhe aktesh nënligjore	X	X	X		X
Shtimi i shërbimeve elektronike			X		
Krijimi i sistemit multifunksional të qendërzuar për lejet e ndërtimit			X		
Prezantimi dhe shtimi i sporteve digjitale	X		X		
Standardizimi i					

Kartelës Informative	X				
Karta e Qytetarit	X		X		
Sistemi elektronik i regjistrimit të recetave elektronike në RSH	X	X	X		X
Sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve		X		X	
Sistemi elektronik i integruar për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit		X	X		

Shqipëria zhvilloi zgjedhjet parlamentare në qershor 2017. Formimi i qeverisë së re u shoqërua me një proces ristrukturimi të thellë institucional që pati ndikim të drejtpërdrejtë tek institucionet qendrore të angazhuara në mbarëvajtjen e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur në vend.

Në këtë kuadër, Zëvendëskryeministri është caktuar si Koordinator i ri Kombëtar në nivel politik i PQH-së në Shqipëri dhe udhëheq GMIP-në për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik.

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri është caktuar si sekretariat teknik për PQH-në dhe GMIP-në për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Ai koordinon procesin e hartimit dhe mbarëvajtjes së angazhimeve në Planin e Veprimit të PQH-së. Institucioni i Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MSHIAP) u shkri.

Planin Kombëtar i Veprimit 2018-20 për PQH-në u hartua dhe do të mbikëqyret përmes mekanizimit të menaxhimit të integruar të politikave, si forumi kryesor në vend për dialogun politik midis përfaqësuesve të qeverisë, partnerëve për zhvillim e integrim dhe shoqërisë civile. Nëpërmjet këtij mekanizmi synohet të arrihet një qëndrueshmëri më e lartë, rritje e ekspozimit të iniciativës së PQH-së në Shqipëri dhe angazhim i më tepër kapaciteteve njerëzore, burimeve teknike dhe financiare për zbatimin e synimeve të ndërrmarra në kuadër të kësaj iniciative.

Ky raport vetëvlerësimi shqyrton progresin e bërë nga Qeveria Shqiptare në zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2016-18, i treti plan veprimi për Shqipërinë, për periudhën e kohore korrik 2016 – qershor 2018. Përgatitja vetëm e raportit të plotë, erdhi si domosdoshmëri pas vështirësive të lindura nga procesi i ristrukturimit të institucioneve qendrore publike. Ky vendim u dakordësua me strukturën qendrore të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur.

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri ka përgatitur raportin e vetëvlerësimit për Planin Kombëtar të Veprimit për PQH-në 2016-18, në bazë të të dhënave të mbledhura nga Ministrinë e Linjës dhe Agjencitë e tjera publike mbi realizimet e angazhimeve përkatëse, në periudhën shtator-dhjetor 2018. Raporti u konsolidua në Janar 2019, pas konsultimit të gjerë nga institucionet e përfshira në të.

Ndërsa jo të gjitha angazhimet e Planit Kombëtar të Veprimit për PQH-në 2016-18 janë zbatuar plotësisht, puna për finalizimin e tyre do të vijojë në kuadër të PKV-së 2018-20 apo nga vetë institucionet e angazhuara jashtë mekanizmit të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur.

Për arsye vijimësie institucionale, në raportin e vetëvlerësimit, referimet ndaj institucioni publik përgjegjës për çdo angazhim janë bërë në përputhje me emërtesat e strukturave të reja, që në mjaft raste janë të ndryshme nga ato të cituara në Planin Kombëtar të Veprimit 2016-18.

Progresi i angazhimeve

1.1 Përmirësimi i portalit me të dhënat e koordinatorëve të të drejtës për informim si dhe programeve të transparencës - IDP

ANGAZHIMI:

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është angazhuar në përmirësimin e portalit pyetshtetin.al me të dhënat e koordinatorëve të të drejtës për informim si dhe programeve të tyre të transparencës.

Përmirësimi konsiston në modelimin e modulit të publikimit të ankesave dhe përgjigjeve që qytetarët i kanë drejtuar institucioneve në kuadër të programeve të transparencës; ai do të qëndrojë gjithashtu i përditësuar me të dhënat më të fundit për koordinatorët në çdo institucion. Ky angazhim nënkupton ofrimin e mundësisë së një gjurmim elektronik të kërkesave për informim dhe ankesave nga vete subjektet e interesuar. Në këtë portal do të gjendet një bazë të dhënash e zgjeruar me programet e transparencës së Autoriteteve publike, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion publik pa kërkesë, si dhe të dhëna për koordinatorët e të drejtës për informim dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve.

STATUSI: Zbatuar

ZHVILLIMI

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale me mbështetjen e shoqërisë civile (Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë "Soros"), ka krijuar në vitin 2015, portalin qendror për të drejtën e informimit "Pyetshteti.al". Ky portal tashmë nuk shërben vetëm për të dhënat mbi koordinatoret apo programet e transparencës por nëpërmjet miratimit të VKM-së nr.145, datë 13.03.2018 "Për krijimin e bazës së të dhenave shtetërore "Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit", është shndërruar në një bazë të dhënash shtetërore në të cilin gjendet informacioni për të gjitha kërkesat/ankesat që i drejtohen Autoriteteve Publike/Zyres së Komisionerit.

Në mars 2018, ky regjister është instaluar në 27 institucione qendrore si: Kryeministria; Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Brendshme; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë; Ministria e Kulturës; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Banka e Shqipërisë; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Agjencia e Prokurimit Publik; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore; Policia e Shtetit; Qendra Kombëtare e Biznesit dhe në njësitë e qeverisjes vendore si: Bashkia Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Tiranë dhe Shkodër. Instalimi i "regjistrat elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit" do të vijojë në të gjitha autoritetet publike.

1.2 Transparenca buxhetore - Ministria e Financave dhe Ekonomisë

ANGAZHIMI: *Ministria e Financave synon përmirësimin e transparencës buxhetore përmes këtij angazhimi duke: përgatitur të gjithë dokumentet e nevojshëm buxhetor të kërkuar, në një format të tillë që struktura e tyre të jetë e qartë dhe e kuptueshme për qytetarët; publikuar në kohë këto dokumente; publikuar në faqen online të MF dhe në media të gjitha aktivitetet e zhvilluara përfshirë seancat dëgjimore për programimin afatmesëm buxhetor për të arritur pjesëmarrje aktive të përfaqësuesve nga organizata të ndryshme me bazë qytetarët, OSHC, nga njësitë e qeverisjes në nivel qendror dhe vendor dhe çdo palë tjetër e interesuar.*

Transparenca në financat publike është një element kryesor i qeverisjes, në mënyrë që informacioni mbi buxhetin të publikohet në kohë, të jetë lehtësisht i aksesueshëm si dhe i qartë për qytetarët. Ky angazhim çon më tej drejt stabilitetit makroekonomik dhe fiskal, si dhe për norma më të larta të rritjes ekonomike. Përpos kësaj, ai ndihmon në përmirësimin e efikasitetit mbi shpenzimet publike.

STATUSI: Zbatim i konsiderueshëm

ZHVILLIMI

Gjatë kësaj periudhe, Ministria e Financave ka avancuar hap pas hapi në përmbushjen e angazhimit të saj në funksion të transparencës buxhetore. Në website-n www.financa.gov.al janë publikuar një listë dokumentash buxhetore, link-e të ndryshme apo portale në funksion të transparencës buxhetore, të cilat renditen si më poshtë:

- 1) Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2019 - 2021
- 2) Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019, faza II-të dhe 2018-2020, faza I-rë;
- 3) Ligji vjetor i buxhetit, nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”;
- 4) Udhëzim Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit 2018”
- 5) Ligji “Për miratimin e buxhetit fatik për vitin 2015”;
- 6) Publikimi i pamfletit “Buxheti i Qytetarit”
- 7) Publikimi i guidës “Buxheti, në një vështrim”

- 8) Publikimi i të gjitha udhëzimeve në funksion të mirëmenaxhimit të financave publike si p.sh udhëzimi “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, “Për zbatimin e buxhetit vjetor të vitit 2017”, etj;
- 9) Raporti i Mes-Vitit 2018 – Vleresimi i situates Makroekonomike, Fiskale dhe Buxhetore per 5M 2018
- 10) Buletini fiskal
- 11) Publikimi dhe aksesimi i portalit të financave vendore <http://www.financatvendore.al/> i cili update-on në çdo kohë të ardhurat, shpenzimet, detyrimet e prapambetura, etj., për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

1.3 Regjistri i integruar i banesave të shtetasve – Ministria e Brendshme

ANGAZHIMI:

Mungon një regjistër i integruar i banesave të shtetasve. Regjistrimi i shtetasve në banesat e tyre do të bëjë të mundur që shumë shërbime të ofrohen për qytetarët nga shtëpitë e tyre; këto shërbime do të ridimensionohen pas krijimit të kësaj baze të dhënash. Një aspekt i rëndësishëm i këtij shërbimi është regjistrimi i banesave të emigrantëve shqiptarë. Kjo do të mundësojë informacione të rëndësishme me përdorim të gjerë nga institucionet shtetërore dhe private (vota e emigrantëve, gjobat në shtëpi dhe shumë përdorime të tjera). Në të gjithë procesin do të përfshihen qytetarët për të verifikuar saktësinë dhe integritetin e të dhënave; një shembull për këtë është që të dhënat për regjistrimin e emigrantëve do të merren përmes vetëdeklarimit. Po ashtu, opinionet e qytetarëve do të merren përmes zyrave të bashkisë dhe zyrave të gjendjes civile në të gjithë vendin.

- Rritja e cilësisë së shërbimeve për qytetarët nëpërmjet regjistrimit të banesave; - Shkrirja e Regjistrimit Kombëtar të Adresave me Regjistrin e Gjendjes Civile; - Popullimi i adresave të qytetarëve

STATUSI:

Në proces

ZHVILLIMI:

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka në administrim Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) Në RKGJC administrohen të dhënat për shtetasit shqiptarë dhe adresa (të dhëna alfanumerike) respektive e tyre (e pa përditësuar). Aktualisht nga ana e DPGJC janë marrë masat për komunikimin midis RKA dhe RKGJC, duke ngritur infrastrukturën e komunikimit midis dy sistemeve.

Në Regjistrin Kombëtar të Adresave, administrohen të dhënat e adresave të objekteve që janë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Konkretisht në këtë sistem ruhen:

- Te dhëna gjeohapësinore lidhur me kufijtë bashkiak, si dhe emërtimi i bashkisë;
- Te dhëna gjeohapësinore lidhur me kufijtë e njësive administrative brenda bashkisë si dhe emërtimi i njësive administrative;
- Te dhëna gjeohapësinore lidhur me kufijtë e kodeve postare, si dhe kodet numerik postare për çdo zone postare;
- Gjurma e pjesëve të territorit publik (bulevard, rrugë, rrugice, shesh, park), si dhe emërtimet përkatëse të tyre dhe klasifikimi sipas njësive administrative dhe bashkive;
- Gjurma e ndërtesës dhe numërtimi përkatës i saj, si dhe përcaktimi se nga cila rrugë është adresuar ndërtesa;
- Numërtimi i hyrjes së ndërtesës;
- Numërtimi i apartamenteve/bizneseve/zyrave për çdo hyrje në ndërtesë.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike realizuan projektin POPULLIMI, Një Qytetar, Një Adresë për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Hapat e ardhshëm lidhen me integrimin e të dhënave të mbledhura gjatë projektit popullimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

1.4 Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike - AKSHI

ANGAZHIMI:

Krijimi i regjistrit për njoftimin dhe konsultimin publik vjen në zbatim të Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në këtë kuadër, ky sistem është konceptuar si një seksion në formën e një forumi virtual interaktiv në unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.al. Çdo institucion vendimmarrës dhe ligjvënës, nëpërmjet një përdoruesi që do të jete në rolin e koordinatorit të institucionit, do të publikojë dhe hedhë për konsultim me qytetarët dhe grupet e interesit çdo projektvendim apo projektligj përpara miratimit të tij. Përfshirja e këtij regjistri dhe përfshirja e sistemit të konsultimit publik brenda tij do të rrisë ekspozimin dhe aksesin e qytetarëve në këtë sistem. Ky investim synon rritjen e transparencës dhe rritjen e angazhimit publik në qeverisje për plotësimin e nevojave funksionale për krijimin e sistemit për njoftimin dhe konsultimin publik.

STATUSI:

Zbatuar

ZHVILLIMI

Me rritjen e kërkesave nga publiku për qeverisje transparente dhe llogaridhënese dhe përpjekjeve të vazhdueshme të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të siguruar një komunikim më të mirë dhe të hapur me qytetarët dhe me shoqërinë civile, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ka ndërmarrë si angazhim në këtë kuadër implementimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në adresën konsultimi.gov.al dhe integrimin e tij në portalin qeveritar e-Albania.

Sistemi është tërësisht funksional sipas parashikimit të projektit, ai mund të aksesohet në linkun: <http://konsultimipublik.gov.al/>. Të gjitha ministritë kanë përzgjedhur një përfaqësues në rang institucional i cili ka për detyrë të koordinojë të gjithë punën në institucionin ku bën pjesë. Çdo ministri ka të drejtën të krijojë një sërë përdoruesish të karakterit “hartues” pra me të drejta për të krijuar/menaxhuar publikime në faqe si dhe të karakterit “moderator” me të drejta për moderimin e komenteve të qytetarëve, në mënyrë që të lehtësojë ndarjen e punës.

Ky regjistër shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet tij sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë

siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara.

Lidhur me sistemin, është zhvilluar dhe një vizitë studimore në Kroaci e organizuar nga OSCE me qëllim marrjen e eksperiencës nga një vend i cili e ka implementuar me sukses një sistem të këtij lloji. Ky aktivitet mundësoi evidentimin e disa ndryshimeve të nevojshme tek platforma “Konsultimi publik” me qëllim rritjen e përdorueshmërisë së saj. Këto ndryshime janë realizuar në kuadër të mirëmbajtjes së projektit.

1.5 Arkiva dixhitale - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit.

ANGAZHIMI:

Nisma e propozuar nga ish Ministria e Zhvillimit Urban dhe Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit ka si objektiv të përgjithshëm ndjekjen dhe përputhshmërinë me zhvillimet e agjendës digjitale në Shqipëri dhe kalimin e AQTN në një stad të avancuar dhe të pranueshëm teknologjik, referuar Enteve analoge në vendet e tjera të BE-së, si dhe enteve të ngjashme në vend. Arkivi duhet të kthehet në një aset nga ana teknologjike dhe e aksesit, të konvertueshëm dhe të krahasueshëm me arkiva analoge evropiane, duke përmirësuar efektivitetin e shërbimit që u ofrohet qytetarëve përmes: - Ofrimit të shërbimeve në internet/intranet nëpërmjet aksesit për qytetarët/subjektet dhe palët e tjera të interesuara që i kërkojnë këto shërbime, akses tek mundësitë materiale në internet. - Krijimit të mundësive për publikimin e shërbimeve teknologjike dhe infrastrukturore, përfitimeve në kohë reale në uljen e kostove të shërbimeve, proceseve njerëzore të automatizuara për kursimin e energjisë. - Reduktimit të përdorimit të dokumenteve dhe materialeve të tjera arkivore të origjinalit duke rritur shkallën e përdorimit të tyre në formë elektronike.

STATUSI:

Zbatuar

ZHVILLIMI

Sistemi i Arkivës Digjitale të AQTN është ngritur me infrastrukturë pranë AQTN, i cili ndihmon në përmirësimin e kushteve, disponueshmërinë dhe sigurinë e informacionit digjital, që disponon Arkivi Qëndror Teknik. Ai përmban modulet e mëposhtme:

Moduli i arkivës: i cili konsiston, në hedhjen e të dhënave në sistemin e arkivës dixhitale, ruajtjen dhe arkivimin e tyre. Sistemi kryen konfigurimet e nevojshme të përdoruesve, për kërkimin, shfletimin dhe shkarkimin në mënyrë më të shpejtë të materjaleve arkivore për shërbim.

Moduli i administrimit të burimeve njerezore: i cili konsiston në sistemin e menaxhimit të burimeve njerezore, sistemit financiar dhe menaxhimit të burimeve.

1.6 Krijimi i një baze të dhënash për arkivimin dhe publikimin e fondeve dhe programeve për kërkimin shkencor në Shqipëri – Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

ANGAZHIMI:

Në Shqipëri ka bashkëpunim të pamjaftueshem mes komunitetit shkencor dhe sektorit privat si dhe mes komunitetit shkencor dhe institucioneve publike në lidhje me hartimin e politikave të kerkimit shkencor ne vend. Një nga arsyt kryesore eshte mungesa e fondeve te nevojshme per PKKZH (Programet Kombetare per Kerkim dhe Zhvillim) ose ne rastin me te mire keto fonde jane shume te pakta. Kjo situatë eshte vene ne dukje vazhdimisht ne Progres Raportet e Komisionit Evropian. Te gjitha rezultatet e hulumtimeve te prodhuara ne Shqiperi me fonde kombetare jane publikuar ne vazhdimesi faqen zyrtare te AKKSHI-t , kjo ne kuader te PHQ por edhe te nismave me te reja sic eshte ajo e Shkence e Hapur (Open Science) dhe të Dhënave të Hapura (Open Data), rekomanduar nga Komisioni Evropian dhe RCC (Regional Cooperation Council). Aktualisht, ka një sërë programesh në vend (me financim publik ose nga fondet e donatorëve) që mbështesin kërkimet. Këto rezultate mund të përblidheshin në një portal të vetëm. Nga ana tjetër të gjitha thirrjet ndërkombëtare për kërkim dhe zhvillim të H2020 janë publikuar në faqen e Agjencisë dhe ju janë shpërndarë të gjithë kërkuesve dhe institucioneve të interesuara në vend. Në shumicën e rasteve për tju ardhur në

ndihmë kërkuarve shumë materiale të rëndësishme janë përkthyer në gjuhën shqipe nga faqet e programeve Evropiane sic është H2020. Po ashtu vetëm në pesë vitet e fundit janë bërë 116 dite informative në të gjitha IAL-t private dhe publike në të gjithë vendin duke trajnuar dhe informuar nga afër komunitetin e kërimit shkencor. Të gjithë kërkuarit dhe institucionet shqiptare kanë pasur akses të vazhdueshëm tek informacionet lidhur me hulumtimet e financuara nga fondet publike dhe private për të nxitur një bashkëpunim më të madh mes komunitetit shkencor, institucioneve publike dhe sektorit privat. Aktivitetet e propozuara në këtë kontekst janë si më poshtë:- Hartimi, miratimi dhe promovimi i standardeve për shkencën e hapur (OS) në Shqipëri. – Krijimi i një portali për aplikime on-line për PKKZH-te dhe për Programet Bilaterale me vendet e tjera në fushën e kërimit shkencor.- Zbatimi i legjislacionit nëpërmjet një akti nënligjor për të mundësuar kërkimin me një ndalesë për botimet dhe të dhënat që rezultojnë nga puna shkencore e ndërmarrë nga institucionet dhe studiuesit shqiptarë (të mbështetur nga burime shqiptare dhe burime të tjera financimi)

STATUSI: Në proces

ZHVILLIMI

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 617, datë 31.8.2016 Agjencia për Kërkime, Teknologji dhe Inovacione u ristrukturua në Agjencinë Kombëtare të Kërimit dhe Inovacionit Shkencor (AKKSHI) dhe u kalua nën varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

AKKSHI ka pasur progres në zbatimin e këtij angazhimi. AKKSHI ka krijuar Data Bazën për të gjithë kërkuarit shkencor dhe Data Bazën e Infrastrukturës kërkimore shkencore të IAL publike/private. Krijimi i bazës së të dhënave po ndikon në:

- Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet kërkuarve shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Rritjes së transparencës në fushën e kërimit shkencor.
- Konsolidimin e të drejtës së autorit në kornizën e kërimit shkencor në Shqipëri

Hapat që priten të ndërmerren përfshijnë:

- Krijimin e moduleve për përpunimin e kësaj baze të dhënash për Kërkimin Shkencor me motorët përkatës të kërkimit që të jenë në gjendje të nxjerrin të dhëna për qëllime të ndryshme;
- Hedhja e certifikimit të të dhënave për kërkimin shkencor;
- Standardizim i procedurave, burime njerëzore në dispozicion, kushte të përshtatshme pune si dhe alokimin e buxheteve.

1.7 Angazhim për të publikuar online në sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacioni qendror dhe vendor – Ministria e Brendshme dhe INFOCIP

ANGAZHIMI:

Infocip konstaton se në mënyrë të posaçme, se aksesimi në legjislacionin qendror dhe atë vendor është një shërbim publik i cili nuk nevojë për përmirësime, pavarësisht kërkesave ligjore gjithnjë e më eksplicite. Angazhimi për të publikuar online në sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacionin qendror dhe vendor. Lidhur me legjislacionin qendror, qeveria angazhohet në publikimin e legjislacionit në faqet zyrtare të Ministrive të Linjës, pa pagesë, në rubrikën: Legjislacion. Lidhur me legjislacionin vendor, Infocip ofron portal vendime.al si një platformë kombëtare, unike në llojin e vet, e cila mund të adoptohet edhe si mekanizëm raportimi.

STATUSI:

Zbatuar

ZHVILLIMI:

INFOCIP ka përmbyllur digitalizimin e plotë të vendimeve të këshillave bashkiake në 61 bashkitë e Shqipërisë. Faza e fundit e procesit u mbështet nga UNDP/STAR 2 duke e zgjeruar bazën e përfitimit me 33 bashki të reja. Vendimet janë të shfletueshme online, si përmes faqeve zyrtare të bashkive përftuese, ashtu edhe përmes Platformës Kombëtare VENDIME.AL

Njoftimi i akteve juridiko-administrative është një shërbim parësor qeverisës. Kushtetuta dhe ligji ngarkojnë institucionet që nxjerrin aktin me detyrimin për njoftimin efektiv të tij subjekteve që duhet ta zbatojnë atë. Vetëm pas njoftimit dhe hyrjes në fuqi konform ligjit, akti fillon të prodhojë pasojat juridike dhe realizon në këtë mënyrë qëllimin e ligj-vënësit. Në këtë kuptim, INFOCIP dhe UNDP/STAR 2 kanë kompletuar standardizimin e plotë të një shërbimi qeverisës, të unifikuar në formë dhe përmbajtje për të 61 bashkitë e vendit.

Përmes këtij procesi, sot këshillat bashkiakë kanë mundësi efektive për të përmbushur shpejt dhe me cilësi detyrimin ligjor për njoftimin e vendimeve të tyre. Procedura e njoftimit dhe hyrjen në fuqi të akteve të pushtetit vendor përshkruhet imtësisht nga ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen

Vendore”. Në këtë kuptim, STAR 2 dhe INFOCIP kanë krijuar shanse reale për rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së ligjit 139/2015.

Po ashtu, të gjithë qytetaret shqiptaret kanë mundësi të njihen shpejt dhe në çdo kohë, pa pagesë për vendimet të cilat merren nga përfaqësuesit e tyre në nivel vendor. Ky dimension transparence në vendimmarrjen vendore përputhet me parimet dhe kërkesat që përmban Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

1.8 Angazhim për standarde open contracting, publikim në formatin open data të kontratave publike – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

ANGAZHIMI:

Qeveria shqiptare është e angazhuar për përdorimin e standardeve të hapura për kontraktim. Shtetet dhe aktorët kryesorë janë aktualisht të prirur për të bërë përpjekjeve për të pasur akses tek informacionet në lidhje me kontratat publike dhe për ecurinë e tyre deri në përfundimin e këtyre kontratave. Regjistri i Koncesionarëve/PPP duhet të ndërtohet në bazë të Ligjit “Për Koncesione dhe PPP”, dhe VKM vlerësohet të ofrojë një format të hapur të dhënash duke siguruar kështu ruajtjen e sekretit tregtar apo intelektual. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve ka ndërmarrë këtë angazhim për të krijuar dhe përditësuar Regjistrin Elektronik të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik-Privat sipas Ligjit nr. 125/2013, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 211, datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve/PPP”. Ky institucion është aktualisht në procesin e mbledhjes së kontratave të fundvitit për 2018-tën. Baza e të dhënave që do të krijohet si rezultat i këtij angazhimi do të jetë publik dhe i aksesueshëm për të gjithë.

STATUSI:

Pjesërisht i zbatuar

ZHVILLIMI

Regjistri i Koncesioneve/PPP-ve është publik dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të agjencisë në linkun: http://www.atrako.gov.al/?page_id=112. Ai ofron kërkim të thjeshtë dhe të avancuar si dhe mundësinë për të konsultuar marrëveshjen koncesionare, me qëllim rritjen e transparencës për kontratat kontratat e koncesionit/PPP.

Gjithashtu, regjistri bën të mundur edhe përpunimin e të dhënave statistikore në lidhje me kontratat e koncesionit/PPP, por jo të gjitha raportet janë në formatin e të dhënave të hapura..Aktualisht në regjistër janë regjistruar 218 kontrata koncesioni/PPP .

2.1 Zbatimi i Ligjit “Për mbrojtjen e Sinjalizuesve”, ngritje kapacitetesh dhe plotësim i akteve nënligjore - Ministria a Drejtësisë**ANGAZHIMI:**

Ky angazhim ka si objektiv rritjen e numrit të denoncimeve për rastet e korrupsionit në autoritetet publike dhe mbrojtjen e informatorëve. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore/Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit hartuan në vitin 2014 projektligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si një mjet i rëndësishëm parandalues dhe raportues i praktikave korruptive brenda autoriteteve publike dhe subjekteve private. Projekt ligji u diskutua gjerësisht me grupet e interesit në komisionet parlamentare dhe u miratua në Kuvendin e Shqipërisë më 2 qershor 2016. Ligj nr. 60/2016 datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” hyri në fuqi më 8 korrik 2016 dhe i shtrin efektet juridike prej datës 1 tetor 2016, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 10, të tij për

sinjalizimin e brendshëm për subjektet private, që fillojnë të zbatohen nga data 1 korrik 2017. (Shënim: Ky ishte një angazhim i planit të dytë kombëtar të veprimit 2014-2016). Produkte të synuara të këtij angazhimi: Hartimi i akteve nënligjore, udhëzimeve përkatëse dhe formave të raportimit të ndjekjes dhe investigimit nga ILDKPKI për zbatimin e suksesshëm të këtij ligji; Konsultime me grupet e interesit në Tiranë dhe rrethet për prezantimin e akteve nënligjore, diskutimin dhe marrjen e rekomandimeve prej tyre; Ngritje kapacitetesh përmes trajnimeve dhe asistencës teknike për stafin e ILDKPKI dhe administratës publike në lidhje me implementimin e suksesshëm të ligjit dhe akteve nënligjore, përgatitjen e përshkrimit të punës për stafin përgjegjës për marrjen e sinjalizimeve dhe ndjekjen e tyre; Fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi në media për ligjin dhe rëndësinë e zbatimit të tij në luftën kundër korrupsionit.

STATUSI:

Zbatuar

ZHVILLIMI

Ligj nr. 60/2016 datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, sanksionon krijimin e një mekanizmi të ri denoncimi dhe goditjeje të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e punës nga punonjësit e një autoriteti publik apo subjekti privat në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim dhe në përgjigje të detyrimeve që kërkohen nga ligji, u miratuan këto akte nënligjore dhe rregullore:

Udhëzimi nr. 1, datë 23.9.2016 “Për miratimin/përcaktimin e strukturës, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit e punonjësve të njësisë përgjegjëse në subjektet private”;

Rregullore nr.2, “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në ILDKPKI”, Shtator 2016;

Rregullore nr.3, “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në ILDKPKI”, Shtator 2016;

Direktiva e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për kushtet, kriteret për përpunimin e të dhënave personale dhe afatin kohor në zbatimin e ligjit nr. 60/2016;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 816. Datë 16.11.2016 "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet, miratuar në mbledhjen e datës 16.11.2016 dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 229 datë 25 Nëntor 2016.

ILDKPKI, Koordinatorin Kombëtar Anti Korrupsion dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe organizata Partnerët Shqipëri ndërmoren një fushatë intensive për konsultimin publik të akteve nënligjore të ligjit “Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, përfshirë zhvillimin e një numri tryezash me pushtetin lokal, bizneset dhe OJF-të në qarqe të ndryshme të vendit.

ILDKPKI dhe institucionet e tjera qendrore dhe vendore u mbështetën nga organizata Partnerët Shqipëri për zbatimin e ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe akteve nënligjore, nëpërmjet trajnimeve të zhvilluara në Tiranë dhe vizitës studimore të stafit të ILDKPI-së në Hollandë, për shkëmbimin e përvojave në zbatimin e ligjit me institucionet homolge dhe kompani private.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, MSHÇV organizoi një fushatë ndërgjegjësimi publik mbi qëllimin, parashikimet, sanksionet dhe përfitimet e tij. Kjo fushatë zgjati 8 muaj dhe pati transmetim të gjerë në median vizive, median sociale dhe aktiviteve promovuese në qytete të vendit. Një fushatë e dytë informuese fokusuar në mekanizmat dhe procedurat konkrete për sinjalizimet u zhvillua gjatë periudhës maj-korrik 2017 në mediat vizive dhe sociale.

Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konflikteve të Interesit (ILDKPKI), si institucioni zbatues i ligjit nr. 60, datë 2.6.2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" ka ndërmarrë masa për të siguruar krijimin e njësisë përgjegjëse në sektorin publik dhe privat. Aktualisht janë 163 njësi përgjegjëse të ngritura në sektorin publik dhe 446 njësi përgjegjëse të ngritura brenda subjekteve private.

ILDKPKI ka ndërmarrë sanksione administrative me "gjobë" për rreth 140 organizata që nuk kanë përmbushur detyrimin për të ngritur një njësi përgjegjëse brenda afatit ligjor të parashikuar në Ligjin nr. 60/2016.

ILDKPKI njoftoi në periudhën nëntor - dhjetor 2017 njësitë përgjegjëse për detyrimin për të miratuar rregulloret e brendshme, si dhe për dorëzimin e raporteve vjetore tek ILDKPKI brenda datës 15 janarit 2018. Më pas, ILDKPKI ka pranuar dhe administruar 161 raporte vjetore nga njësitë përgjegjëse e autoriteteve publike.

Në vitin 2017, shtatë njësi përgjegjëse regjistruan dhe trajtuan praktikatat sinjalizuese në bazë të ligjit, ndërsa ILDKPKI ka vepruar si mekanizëm i jashtëm raportimi në tetë raste të tjera, të cilat u regjistruan dhe hetuarn.

ILDKPKI-ja, gjatë periudhës janar-qershor 2018, ka regjistruar tetë raste të reja, që janë hetuar ose janë në proces hetimi.

3.1 Ofrimi i shërbimeve elektronike – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

ANGAZHIMI: *Ky angazhim synon që nëpërmjet projekteve të ndryshme për shtim shërbimesh apo zgjerimin e ndërveprimeve mes sistemeve të institucioneve në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, të shtojë numrin e shërbimeve elektronike të ofruara për qytetarët, bizneset dhe punonjësit e administratës publike.*

STATUSI: Zbatuar

ZHVILLIMI

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka vijuar punën për shtimin e shërbimeve elektronike dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese në portalin unik qeveritar e-Albania, ndërkohë është rritur edhe numri i sistemeve të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit.

Ndryshimet ligjore dhe nënligjore përkatëse të miratuara përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 495, datë 13.09.2017, "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike", hapën rrugën e legjitimitimit të vulës elektronike, duke i dhënë vlefshmëri ligjore dokumenteve administrative të gjeneruara përmes portalit e-Albania. Në bazë të vendimit, dërgimi dhe pranimi i të dhënave kryhen në përputhje të plotë me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, ndërsa vulosja e dokumenteve administrative

elektronike, të gjeneruara nga transmetimi elektronik, garanton autenticitetin e dokumentit në formatin elektronik. Aplikimi dhe përfitimi i dokumenteve që përmbajnë vulën elektronike kryhet përmes identifikimit elektronik, në portalin e-Albania. Prej shtatorit 2017 kur u legjitimua vula elektronike, portali e-Albania mundëson shkarkimin e dokumenteve administrative me vlerë ligjore 24/7, duke i bërë këto dokumente të disponueshme në çdo orë të ditës dhe në çdo ditë të javës, pavarësisht orarit të hapjes së sporteleve shtetërore. Aktualisht në portal ofrohen 33 dokumente me vulë elektronike, një pjesë prej së cilave ofrohen vetëm elektronikisht, duke eliminuar tërësisht printimin e tyre në letër në sportelet fizike të institucioneve.

Përpos vulës elektronike, risia tjetër është përdorimi i portalit e-Albania për punonjësit e administratës publike për të marrë vërtetime dhe dokumente të cilat gjenden si shërbime të portalit për plotësimin e dokumentacionit shoqëruar të shërbimit të kërkuar nga qytetari dhe nuk do t'i kërkohen më vetë atij. Sot, është punonjësi i administratës publike dhe jo qytetari, ai që ka detyrën e mbledhjes së dokumenteve me vulë elektronike nga portali e-albania dhe bashkëlidhjes së tyre në dosjen e aplikimit të qytetarit. E thënë më thjesht: itinerari i zakonshëm nga zyra në zyrë për një certifikatë, vërtetim etj., ka marrë fund.

Përgjatë 24 muajve të fundit janë ndërmarrë një sërë projektesh që kanë bërë të mundur dyfishimin e numrit të e-shërbimeve të ofruara në portalin unik qeveritar e-Albania. Aktualisht në portal ofrohen 590 shërbime elektronike niveli 3-4 në krahasim me 248 shërbime elektronike nivelit 3-4 të ofruara në fillim të këtij angazhimi. Një gamë e madhe shërbimesh publike që ofroheshin vetëm në modelin tradicional, që kërkonin paraqitje në zyrat përkatëse, aplikim shkresor, pritje në radhë, plotësim formularësh etj., sot merren në rrugë elektronike, me një sportel, nga një aparat telefoni smartphone, një kompjuter në shtëpi.

Ndërveprimi midis bazave të të dhënave shtetërore përmes Platformës Qeveritare të Ndërveprimit falë webservice-ve të ngritura mundëson lehtësimin e procedurës së aplikimit të qytetarëve përmes plotësimit automatik të një pjese të formularit të aplikimit. Për sa përket Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG), AKSHI ka vazhduar të investojë me qëllim rritjen e ndërveprimit të regjistrave elektronikë që janë të lidhur në GG. Janë 48 regjistra elektronikë të lidhur në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, ku 60% e fushave në formularët e aplikimit plotësohen automatikisht nga ndërveprimi dhe shkëmbimi i të dhënave midis këtyre regjistrave në kohë reale. Në portal ofrohen shërbime që janë ri-inxhinierizuar 100% duke ofruar një shërbim tërësisht paperless, si dhe shërbime të tjera që kërkojnë ngarkim dokumentacioni të aplikuesit.

3.1.1 Implementimi online i shërbimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme

Projekti synonte dixhitalizimin e 36 shërbimeve të ofruara nga Përfaqësitë Diplomatike dhe Konsullore në portalin e shërbimeve unike qeveritare e-Albania.al. Projekti kishte si objektiv

gjithashtu përshtatjen e faqeve te internetit të çdo konsullate me elementet: trokitje virtuale, tur virtual në 3D për çdo konsullate dhe orientimin e vizitorëve të faqeve në paketën e e-shërbimeve.

Implementimi i projektit përfundoi me sukses brenda vitit 2016, duke arritur:

- Publikimin e 36 shërbimeve elektronike në portalin qeveritar e-Albania në muajin nëntor dhe dhjetor 2016.
- Përshtatje e faqeve te internetit të çdo konsullate me elementet: trokitje virtuale, tur virtual në 3D për çdo konsullate dhe orientimin e vizitorëve të faqeve në paketën e shërbimeve.

Për marrjen e shërbimeve në formatin tradicional, qytetarëve shqiptarë jashtë iu duhej të linin ditën e punës, të humbnin kohë të vlefshme, të udhëtonin distanca të largëta nga qyteti i banimit për t'u paraqitur në përfaqësi, kundrejt kostove përkatëse financiare dhe shpesh ishin të pasigurt në marrjen e shërbimit, pasi mund të mos ishin të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për shërbimin e kërkuar. Shërbimet online mundësuan që të kursehet edhe kohe, edhe para. Dixhitalizimi i shërbimit konsullor nga ana tjetër, e mban shërbimin konsullor transparent, të monitorueshem në kohe reale ndërsa xhepin e tunduar e mban në distancën e nevojshme të sigurisë nga nevojtarit duke reduktuar ndjeshëm korrupsionin.

Shërbimet elektronike që janë aktive përmes portalit e-Albania, japin përgjigjen optimale për kërkesat përherë e më të mëdha në adresë të zyrave konsullore shqiptare. Shërbimet konsullore dixhitale si standard i prezantuar rishtas, rregullojnë raportin mes fluksit të kërkesave dhe domosdoshmërisë së garantimit të veprimeve të sigurta, të shpejta dhe pa nevojën e paraqitjes fizike në selitë konsullore për pjesën më të madhe të shërbimeve. Ky ka qenë edhe një nga problemet më të mëdha, me kosto për emigrantin shqiptar që tashmë ka mundësi të kryejë aplikimet në çdo kohë dhe nga çdo pikë aksesimi në internet.

Për periudhën qershor 2016 – korrik 2018, janë regjistruar 301,743 përdorime të shërbimeve dhe 73,700 aplikime për shërbimet konsullore. Gjithashtu, është punuar edhe për shtimin e dy shërbimeve të reja elektronike konsullore në portalin e-albania.

3.1.2 e-Ekzaminime/e-Referime (Sistemi i menaxhimit të radhës për ekzaminime të avancuara mjekësore)

Qëllimi i sistemit është rezervimi dhe regjistrimi online nga shtetasit për ekzaminimet e avancuara mjekësore. Sistemi ofron mundësinë e ndërveprimit të mjekëve (mjekut të familjes, mjekut specialist, mjekut që kryen ekzaminimin) dhe në sajë të tij është dixhitalizuar procesi i menaxhimit dhe rezervimit të ekzaminimeve të avancuara mjekësore (në sistem ruhen të gjitha të dhënat e mëposhtme: rekomandimi i mjekut të familjes, referenca e mjekut specialist, rezervimi i

ekzaminimit të avancuar mjekësor, përgjigjja e mjekut të ekzaminimit dhe interpretimi i rezultatit të mjekut specialist).

Sistemi, i cili është shtrirë tashmë në gjithë vendin, administrohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe bën të mundur rezervimin online nga shtetasit për ekzaminimet e avancuara mjekësore.

Gjithashtu janë publikuar në portalin e-albania 34 shërbime elektronike që mundësojnë rezervimin e radhës për ekzaminimet e avancuara mjekësore, konsultimin online të rekomandimeve të marra nga mjeku dhe mundësinë e ngarkimit të një rekomandimi të skanuar, për të bërë më pas rezervimin e radhës në bazë të këtij rekomandimi (në rastet kur rekomandimi nuk është ngarkuar nga mjeku).

Sistemi i ri ka ndikim në disa drejtime konkrete. Së pari ai plotëson standardin e sjellë nga dy shërbime të tjera parësore që janë aktive në portalin e-albania: shërbimi për Kartën e Shëndetit dhe ai për Kontrollin Mjekësor Bazë. Në vetvete ato japin një kontribut thelbësor për regjistrin shëndetësor të popullatës, që është statistikë interaktive shumë e rëndësishme, ndërkohë që e-ekzaminimet e pasurojnë më tej atë, duke edukuar gradualisht popullsinë me një kulturë të re të kërkimit të shërbimeve në këtë drejtim.

Përfitimet nga zbatimi i projekti janë praktike; ato adresojnë disa nga problemet kronike të shërbimit mjekësor të nivelit të dytë e të tretë.

Projekti transformon mënyrën e kërkimit të shërbimeve nga qytetarët dhe për rrjedhojë edhe dhënien e tij në mënyrë më cilësore dhe programuar nga sistemi shëndetësor. Gjithashtu, përmes dhënies së referimit në formë elektronike është krijuar arkiva elektronike e referimeve, duke bërë një tjetër hap të rëndësishëm drejt e-Shëndetësisë.

Përmes implementimit të këtij sistemi është arritur:

- Rritja e aksesit dhe transparencës me shtetasit për rezervim online të ekzaminimeve me pajisje mjekësore;
- Ulje e kohës së përgjigjes ndaj shtetasve për datën e caktimit të marrjes së ekzaminimit të avancuar me pajisje mjekësore;
- Caktimi online i institucionit shëndetësor në të cilin do të kryhet ekzaminimi i avancuar shëndetësor duke i caktuar pacientit një numër radhe virtuale;
- Menaxhim më të mirë dhe të kontrolluar të kohës së stafit mjekësor për kryerjen e këtyre ekzaminimeve të avancuara;
- Ulje e radhëve të pritjes së shtetasve për të tilla ekzaminime;
- Krijimi i versionit mobile application për e-ekzaminimet dhe mundësimin e aksesimit nga pajisje mobile dhe telefonë inteligjente.

3.1.3 Shtimi i 209 shërbimeve të reja për 18 institucione në portalin e-Albania sipas marrëveshjes me institucionet përfituese

Implementimi i këtij projekti ka rëndësi dhe ndjeshmëri të lartë pasi ndihmon institucionet e përfshira për të zvogëluar punën manuale me letra, që është më e ngadaltë sesa përpunimi elektronik i informacionit duke përdorur forma elektronike për komunikim me qytetarët si dhe do të ndihmojë këto të fundit dhe biznesin për të zvogëluar kohën e marrjes së shërbimeve. Ndër komponentët që me implementimin e këtij projekti janë arritur janë: përmirësimi dhe modernizimi i shërbimeve publike si dhe rritja e performancës së institucioneve në nivel qendror dhe vendor.

Me anë të këtij projekti është ndërtuar Sistemi i Menaxhimit të Formave Elektronike (e-Forms) që ka pasur si qëllim dërgimin e kërkesave për e-shërbime nga qytetarët me anë të formularëve (e-Forms) nga portali qeveritar e-Albania drejt institucioneve ofruese të shërbimit. Përmes këtij projekti janë shtuar shërbime të reja elektronike në portalin e-Albania

Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ofronë një gamë prej 51 shërbimesh që lidhen me të gjitha kategoritë e pronës së paluajtshme. Ato nisin që nga më të rëndësishmet që janë regjistrimet e çdo lloji, e deri te korrigjimet e ndryshme apo kopje hartash. Dixhitalizimi i të 51 shërbimeve që ofrohen nga ZRPP-ja, bashkë me dixhitalizimin në proces të regjistrave të pasurive të paluajtshme është një ndërhyrje themelore në atë që qeveria e ka quajtur reformë në shërbimet publike.

Të gjitha procedurat që janë aktive kërkojnë regjistrim dhe identifikimin e përdoruesit, çka do të thotë se çdo veprim lë gjurmë në sistem duke krijuar në këtë mënyrë garanci juridike për qytetarët se problemi i deridjeshëm i ndërmjetësimit të shërbimit zyrtar përmes sekserëve të eliminohet përfundimisht. Aplikimi përmes portalit është formalisht dhe praktikisht protokollim automatik i aplikimit që lë gjurmë unike në sistem dhe ai detyron njoftimin e aplikuesit në rrugë elektronike, e-mail, apo në hapësirën e posaçme personale në portal, për statusin zyrtar të aplikimit të tij. Të gjitha shërbimet shoqërohen me suportin teknik online (live chat) që i ndihmon aplikuesit të sqarojnë çdo paqartësi procedurale, ndërkohë që disponibiliteti i portalit me 99% të funksionalitetit 24/7, jep mundësi që faza e parë e procedurave që lidhen me pasurinë e paluajtshme, aplikimi/kërkesa për shërbimet nga ZRPP-ja të kryhet në çdo kohë dhe ngado. Ky është një aspekt i rëndësishëm, pasi siç dihet shërbimet e ZRPP-së në sportelet tradicionale ofrohen në përputhje me ndarjen administrative, që do të thotë se në masë të madhe rastesh, finalizimi i aplikimit detyronte qytetarët të paraqiteshin në sportele jashtë vendbanimit të tyre.

Nga ana tjetër, dixhitalizimi i shërbimeve për aplikimin për 63 licenca në Qendrën Kombëtare të Bizneseve, i vjen në ndihmë subjekteve të interesuara në ushtrimin e aktivitetit. Ai vë në veprim praktikën e re të aplikimit online me dokumente të nënshkruara elektronikisht duke ofruar shërbime PaperLess, për dixhitalizimin e plotë të shërbimeve publike. Po kështu aplikimi përmes portalit e-albania mundëson shërbim të thjeshtuar dhe të shpejtë, me një sportel për biznesin teksa përpunimi i tij, statusi dhe përgjigja bëhen me dije në rrugë elektronike.

Kjo vlen edhe për biznesin që kërkon p.sh një vërtetim xhiroje për tri vitet e fundit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve: me anë të shkarkimit online në dokumentit së bashku me vulën dixhitale shmanget humbja e kohës si dhe veprime të tjera burokratike që do të sillnin kosto të tjera për biznesin. Ky është vetëm një nga 9 e-shërbimet që ofrohen me vulë dixhitale edhe për lehtësimin e kësaj kategorie.

Shërbime të tjera elektronike që janë implementuar përmes këtij projekti ofrohen nga institucione si Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Kopshte/gjumnaze/shkolla, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Trajtimin të Pronave, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

3.2 Krijimi i sistemit multifunksional të qendëruar për lejet e ndërtimit – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit\.

ANGAZHIMI: *Qëllimi i këtij angazhimi është ndërtimi i një sistemi multifunksional dhe të qendëruar për të lehtësuar procedurat e aplikimeve për leje zhvillimi dhe ndërtimi, duke iu dhënë mundësinë qytetarëve dhe bizneseve të aplikojnë online. Duke qenë një sistem i qendëruar synohet që të aksesohet në mënyrë elektronike nga të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe të gjithë institucionet e tjera të përfshira në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet llogarive përkatëse*

STATUSI: Zbatuar

ZHVILLIMI:

Në zbatim të këtij angazhimi është bërë e mundur ndërtimi i një sistemi multifunksional për të lehtësuar procedurat e aplikimeve për leje ndërtimi dhe zhvillimi duke dhënë mundësinë që qytetarët dhe bizneset të aplikojnë online. Duke qenë një sistem i qendëruar, ai aksesohet në

mënyrë elektronike nga 61 NJQV-të dhe të gjithë institucionet e tjera të përfshira në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet llogarive përkatëse. Gjithashtu, ky projekt realizoi edhe komunikimin me regjistrat elektronikë të institucioneve të tjera për verifikime apo marrje automatike të të dhënave të aplikantëve, nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, si dhe gjurmimin e statusit të aplikimit në çdo fazë të tij, nëpërmjet sistemit e-Tracking.

Krijimi i sistemit multifunksional të qendëruar për lejet e ndërtimit (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=6093>) ridimensionon tërësisht ofrimin e këtij shërbimi për qytetarin dhe biznesin shqiptar. Sistemi i prezantuar për herë të parë në Shqipëri përfshin aplikimin për leje ndërtimi, zhvillimi etj., trajtimin e aplikimeve nëpërmjet sistemit tërësisht në formë elektronike. Institucionet detyrohen të japin përgjigje zyrtare në një afat që nuk mund të shkojë më shumë sesa 60 ditë. Nënshkrimi elektronik për dokumentet shoqëruese garanton autenticitetin e tyre si dhe siguron një shërbim të vlefshëm ligjërish. Shërbimi unifikon portën e aplikimit për subjektet duke eliminuar nevojën për të paktën 238 shkresa përcjellëse. Nëse do të flisnim për letër, eliminohen mbi 23 mijë shkresa përcjellëse, e me to edhe nevoja për arkivat fizike, që në finale janë kosto shtesë.

Duke filluar nga data 1 Shtator 2016 aplikimet për leje ndërtimi apo çdo lloj kategorie tjetër leje që ka lidhje me ndërtimin (leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklaratë paraprake, njoftim për certifikate përdorimi etj) bëhet vetëm nëpërmjet sistemit online.

Qytetarët/Subjektet/Institucionet/Bizneset mund të aplikojnë online për t'u pajisur me leje ndërtimi nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania duke plotësuar formularin e aplikimit se bashku me dokumentacionin shoqërues dhe duke e dërguar atë drejt njëres prej 61 NJQV-ve apo drejt AZHT, në varësi të tipit të ndërtimit apo punimit që do kryhet.

Ky aplikim i dërguar, më pas, merret në shqyrtim nga bashkia përkatëse apo AZHT. Me implementimin e sistemit multifunksional të lejeve të ndërtimit, procedura është informatizuar në pothuajse të gjithë hallkat e punës që nga momenti i aplikimit të qytetarit deri në dhënien e lejes të ndërtimit apo lejeve të tjera.

Gjatë periudhës Qershor 2016 - Korrik 2018 janë bërë 20.854 aplikime për leje në Republikën e Shqipërisë.

3.3 Prezantimi dhe shtimi i sporteve dixhitale - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

ANGAZHIMI: *Nëpërmjet shpërndarjes së sporteve digjitale, portali unik qeveritar e-Albania synon të ofrojë akses dhe kërkim më të lehtë në internet për të gjithë qytetarët shqiptarë të cilët mund të drejtohen në një pikë të vetme aksesi publik për të marrë informacion apo shërbimet publike online që ofrohen nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania. Sportelet digjitale të shërbimeve publike ofrojnë nëpërmjet automatit shërbime publike 24/7. Me anë të kioskave digjitale bëhet e mundur që shërbimet e ofruara nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania të kenë mundësi aksesi nga të gjithë qytetarët shqiptarë.*

STATUSI: Zbatuar

ZHVILLIMI

Me qëllim përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarit si dhe me qëllim promovimin e teknologjive me të fundit, AKSHI ka ndërmarrë iniciativën për të përhapur në vendin tonë kioskat digjitale. Me anë të tyre bëhet e mundur që shërbimet e ofruara nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania të kenë mundësi aksesi nga të gjithë qytetarët shqiptarë.

Prezantimi i kioskave digjitale ka sjellë rritje të transparencës për shërbimet e ofruara nga administrata. Në këtë mënyrë, nëpërmjet mundësimin të ofrimit të shërbimeve elektronike përmes sporteve digjitale synohet të përmirësohet disponueshmëria, cilësia dhe transparenca e shërbimeve publike si dhe të reduktohet koha e zbatimit të procedurave dhe kostot e administratës publike.

Nëpërmjet shpërndarjes së sporteve dixhitale, portali unik qeveritar e-Albania ofron akses dhe kërkim më të lehtë në internet për të gjithë qytetarët shqiptarë të cilët mund të drejtohen në një pikë të vetme aksesi publik për të marrë informacion apo e-shërbimet publike online që ofrohen nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania. Sporteli digjital i shërbimeve publike ofron nëpërmjet

automatit shërbime publike 24/7. Sportelet janë të vendosura në 15 pika* në Shqipëri, në qytetet kryesore të vendit, në sportelet e institucioneve me më tepër fluks qytetarësh.

** Bashkia Tiranë, Bashkia Shkodër, Bashkia Korçë, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Elbasan, ADISA Krujë, ADISA Gjirokastër, ADISA Tiranë (sportelet e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), DPSHTRR Tiranë, QKB Tiranë, FSDKSH Tiranë, Bashkia Sarandë, ADISA Fier, ADISA Kavajë, FlagShip Center Durrës.*

3.4 Standardizimi i Kartelës Informuese – Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara

ANGAZHIMI: *Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara përmes kartelës informative e cila do të jetë në funksion të të gjithë qytetatëve të Republikës së Shqipërisë synon shpërndarjen, thjeshtëzimin si dhe unifikimin e informacionit, për të gjitha shërbimet publike. Kjo do të sjellë një pasqyrë të qartë tek qytetaret për mënyrën e lëvrimit të shërbimeve publike.*

STATUSI: Zbatim i konsiderueshëm

Objektivat kryesore të kartelave informative janë:

- Thjeshtëzimi i informacionit për qytetarët për mënyrën e përfitimit të shërbimeve publike;
- Unifikimi i organizimit të informacionit për shërbimet publike; dhe
- Standardizimi i tij, me qëllim përdorimi jo vetëm në zyrat pritëse por edhe në Call Center dhe në portalin online qeveritar e-Albania.

ZHVILLIMI

Formati i Kartelës Informative është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave .Gjatë kësaj periudhe janë hartuar 890 Kartela Informative, nga të cilat 599 prej tyre janë validuar nëpërmjet Platformës IPSD. Kartelat Informative janë publikuar në Website ADISA, e-albania, si dhe aksesohen nga operatorët e Call Center ADISA, me qëllim dhënien e informacionit mbi shërbimet publike.

b) Call Center ADISA

Në qendrën e telefonisë ADISA me numrin 11-800, e cila përfaqëson një kanal shtesë për informimin mbi shërbimet publike, gjatë kësaj periudhe është shtuar numri i shërbimeve dhe institucioneve për të cilat ofrohet informacion nëpërmjet Kartelave Informative të përgatitura. Operatorët e Call Center japin informacion për 535 Kartela Informative të 22 institucioneve shtetërore, përkatësisht: Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Ndërtimeve Informale, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Qendra Kombëtare e Biznesit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Social Shtetëror dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive.

b) ADISA Mobile App

ADISA ka vendosur në AppStore e në Playstore aplikacionin e telefonisë mobile “ADISA Mobile App”, aplikacion ky i cili i sjell shërbimet publike më afër qytetarit, duke informuar për mbi 500 shërbime duke krijuar mundësinë për të rezervuar biletë për marrje shërbimi pranë Sportelit Pritës ADISA pranë ZVRPP Tiranë.

3.5 Karta e Qytetarit - Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara

ANGAZHIMI:

Karta e qytetarit përfaqëson angazhimin e qeverisë në drejtim të standardeve, cilësisë, transparencës së shërbimeve, si dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, duke përcaktuar qartë pritshmëritë. Ajo do të hartohet nga çdo institucion në bashkëpunim me ADISA-n, në zbatim të përgjegjësive të përcaktuara me ligj dhe të standardeve të unifikuara të miratuara për shërbimet ndaj qytetarit dhe biznesit.

STATUSI:

Në vazhdim

ZHVILLIMI

Si institucion, fokusi i të cilit është ofrimi i shërbimeve publike, një nga detyrat kryesore të ADISA, është dhe shërbimi ndaj qytetarit me cilësi, transparencë, brenda afatit kohor dhe standarde të ngjashme me vendet perëndimore, të cilat shërbyen si model përshtatjeje dhe studimi për hartimin e Kartës së Qytetarit.

Ky dokument, garanton respektimin e të drejtave të qytetarëve në përfitimin e shërbimeve publike duke shërbyer si një dokument për rritjen e transparencës, qasjen qytetare, lëvrimin, shpejtësinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit me parimin kryesor ofrimin e mjeteve për luftën kundër korrupsionit.

Gjithashtu gjatë muajit maj, gjatë javës së Inovacionit është bërë prezantimi i Kartës së Qytetarit për nxënësit e gjmnazeve dhe për të gjithë pjesëmarrësit në këtë aktivitet. Një tjetër promovim u bë edhe në Konferencën Rajonale Ballkanike, po në muajin maj, e cila pati në fokus progresin e reformës të shërbimeve publike në rajon.

Prezantim dhe promovim i Kartës së Qytetarit është bërë dhe gjatë muajit korrik, në takimin e katërt të Grupi tematik: Ofrimi i Shërbimeve Publike, ku është prezantuar metodologjia dhe elementët e kartës së Qytetarit dhe rëndësia e saj mbi transparencën dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike.

Karta e qytetarit, duhet të hartohet nga çdo institucion në bashkëpunim me ADISA-n, në zbatim të përgjegjësisve të përcaktuara me ligj dhe të standardeve të unifikuara të miratuara për shërbimet ndaj qytetarit dhe biznesit.

Në kartë do të përfshihen për çdo shërbim informacioni bazë:

- për mënyrat/ kanalet për marrjen e shërbimit;
- kërkesat dhe oraret;
- tiparet e matshme, si kostoja, afatet;
- pika e kontaktit dhe procesi i trajtimit të ankesave.

Në kuadër të zbatimit të parimit kryesor të kartës së Qytetarit, për ofrimin e mjeteve për luftën kundër korrupsionit, ADISA është anagazhuar dhe ka nisur procesin, që nëpërmjet kioskave të denoncimit të korrupsionit, të cilat do të vendosen pranë sporteleve të Zyrrave Rajonale/ Vendore, të denoncohen rastet korruptive të punonjësve të saj në Zyrrat Qendrore dhe Zyrrat Rajonale/Vendore. Gjithashtu do të krijohet dhe një hapësirë përkatëse në portalin www.adisa.gov.al.

Karta e Qytetarit është miratuar me VKM Nr. 623, datë 26.10.2018.

3.6 Sistemi elektronik i regjistrimit të recetave elektronike në RSH – Ministria e Shëndetësisë.

ANGAZHIMI:

Ky angazhim synon të zëvendësojë recetën mjekësore në letër me recetë elektronike në rang kombëtar. Përbushja e këtij angazhimi sjell rritje të efikasitetit të fondeve të rimbursimit të barnave mjekësore si dhe saktësinë e përcaktimit të barnave mjekësore duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shëndetit të pacientëve dhe kujdesit shëndetësor.

STATUSI:

Në proces

ZHVILLIMI:

Pas zbatimit dhe testimit me sukses të sistemit të recetës elektronike pilot në Qarkun e Durrësit, Ministria e Shëndetësisë përgjatë 2017 filloi shtrirjen dhe funksionimin e sistemit të recetës elektronike kombëtare e-Rx në qarqet Durrës, Tiranë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Elbasan. Sistemi kombëtar i recetës elektronike u plotësua me modulet informatike ekzistuese si sistemi e-Farmacia, receta e rimbursueshme, moduli financiar, sistemi i nënshkrimit elektronik, si dhe u reflektuan në sistem listat e kufizimeve të përgatitura nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Projekti i recetës elektronike kombëtare filloi zbatimin njëkohësisht me sistemin e nënshkrimit elektronik për dhënësit e shërbimit shëndetësor.

Zbatimi i sistemit të recetës elektronike u shoqërua me proceset e trajnimit të mjekëve, farmacistëve, punonjësve të FSDKSH mbi aspekte të ndryshme të gjenerimit, nënshkrimit dhe ekzekutimit të recetës elektronike dhe saktësisë të regjistrimit online dhe kategorive të përfituesve për të cilët gjenerohet recetë elektronike.

Përgjatë vitit 2017 është mundur shtrirja e recetës elektronike në 225 (55.2 %) qendra shëndetësore, 670 farmaci (73 %) dhe pranë 1100 mjekëve (69 %) dhe 792 (73 %) farmacistëve në qarqet Durrës, Tiranë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Elbasan. Paralelisht me procesin e shtrirjes së recetës elektronike kombëtare u krye dhe pajisja e rreth 1100 mjekëve dhe rreth 400 farmacistëve me USB që mbartin nënshkrim elektronik.

4.1 Sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

ANGAZHIMI:

Ky angazhim ka si objektiv krijimin e një sistemi të integruar që do të mundësojë monitorimin e aktiviteteve të paligjshme dhe identifikimin në kohë të zjarreve, si një nga objektivat strategjike të programit të qeverisë për pyjet. Ky angazhim ka këto objektiva: 1. Krijimin e sistemit të integruar për monitorimin e pyjeve për të parandaluar prerjen e paligjshme të pyjeve; 2. Detektimin dhe zbulimin në kohe reale të zjarreve që mund të ndodhin në pikat që do të mbulohen nga sistemi; 3. Monitorimin 24 orë në 365 dite të vitit, të pikave kyçe të përcaktuara për parandalimin e prerjeve të paligjshme dhe kontrollin e transportit të materialit drusor nga pyjet në drejtim të qendrave urbane ku ai grumbullohet e tregtohet. 4. Përmirësimin e cilësisë së shërbimit për parandalimin e kundërvajtjeve për prerjen e pyjeve; 5. Shkëmbim informacioni në kohe reale me strukturat e tjera përgjegjëse për monitorimin dhe ndjekjen e autorëve të veprimeve të kundra ligjshme; 6. Uljen e nivelit të korrupsionit në sektorin e pyjeve.

STATUSI:

Zbatuar

ZHVILLIMI:

Prerja e paligjshme e pyjeve është një nga aktivitetet ilegale me impakte të mëdha në dëmtimin e ekosistemeve pyjore dhe mjedisit në tërësi duke shkaktuar një zinxhir pasojash negative. Në total, në të gjithë Shqipërinë janë implementuar 28 pika vrojtimi, dhe konkretisht në qarqet Dibër, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkodër, Iranë dhe Durrës. Në rast evidentimi të kundravajtjeve janë njoftuar menjëherë rrethet përkatëse të atyre qarqeve që është konstatuar.

Ky sistem gjithashtu ka ndikuar në parandalimin e kontrabandës së lëndës drusore. Zyra e monitorimit pranë ISHMPUT funksionon 24 orë, cdo ngjarje, informacion apo problematikë, regjistrohet në librin e shërbimit pranë zyrës së monitorimit.

4.2 Sistemi elektronik i integruar për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

ANGAZHIMI:

Përmirësimi i shërbimeve ndaj përfituesve të shërbimit në lidhje me licensimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit. Në këtë mënyrë, qytetarët, bizneset dhe palët e interesit do të mund t'i referohen një informacioni të qenësishëm dhe të validuar, përsa i takon individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

STATUSI:

Zbatuar

** Prej datës 21 janar 2017 shërbimi përmarrjen e licenave profesionale në këto fusha ofrohetvetëm online.*

ZHVILLIMI

Ministria e Zhvillimit Urban ka qenë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, të strategjive e të politikave (ndër të tjera), në fushën e licencimit profesional të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit, si dhe në fushën e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, në zbatim të VKM Nr. 759 datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” të ndryshuar me VKM Nr. 943 datë 28.12.2016, si dhe në zbatim të VKM Nr. 712, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat

e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme.

Shërbimet online të ofruara për licencat profesionale, janë:

I. Në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit:

1. Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë.
2. Ekuivalentim i licencës individuale.
3. Ekuivalentim i licencës së shoqërive të huaja.
4. Ndryshime apo shtesa të drejtuesve teknik të shoqërisë.
5. Ndryshime apo shtesa të drejtuesit ligjor.
6. Ndryshime emërtimi – ose selie të shoqërisë.
7. Pajisje me licencë individuale për herë të parë.
8. Pajisje me licencë shoqërie për herë të parë.
9. Pajisje me shtesa në kategoritë e licencës individuale.
10. Pajisje me shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë.
11. Pajisje me dublikatë të licencës individuale.
12. Rinovim i kategorive të licencës individuale.
13. Rinovim i kategorive të licencës së shoqërisë.
14. Zgjatja e afatit të licencës së shoqërisë apo dublikatë.

II. Në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme:

1. Dublikatë të licencës individuale të vlerësimit.
2. Pajisja me licencë individuale për herë të parë, shkalla e dytë.
3. Pajisja me licencë për shoqëri për herë të parë.
4. Rritje të shkallës së licencës të vlerësimit për shoqëri.
5. Ndryshim të emërtimit të shoqërisë.
6. Ndryshim apo shtesa të vlerësuesve të shoqërisë.
7. Rinovim apo dublikatë të licencës së shoqërisë.
8. Rinovim i licencës individuale të vlerësimit.
9. Rritja e shkallës së klasifikimit nga e II-të, në të I-rë

1. Lutemi gjeni më poshtë përmbledhjen e statusit për çdo angazhim:

Nr.	ANGAZHIMI	STATUSI	SFIDA E PHQ
1.1	Përmirësimi i portalit me të dhënat e koordinatoreve të të drejtës për informim si dhe programeve të transparencës	Zbatuar	Rritja e integritet publik .
1.2	Transparenca buxhetore	Zbatim i konsiderueshëm	Rritja e integritet publik, Menaxhim më efektiv i burimeve publike.
1.3	Regjistri i integruar të banesave të shtetasve	Në proces	Menaxhim më efektiv i burimeve publike, Përmirësimi i shërbimeve publike, Krijimi i komuniteteve të sigurta
1.4	Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike	Zbatuar	Përmirësimi i shërbimeve publike
1.5	Arkiva digjitale	Zbatuar	Menaxhimi më efektiv i burimeve publike, Përmirësimi i shërbimeve publike
1.6	Krijimi i një baze të dhënash për arkivimin dhe publikimin e fondeve dhe programeve për kërkimin shkencor në Shqipëri	Në proces	Rritja e integritetit publik, Menaxhimi më efektiv i burimeve publike
1.7	Angazhim për të publikuar online ne sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacionin qendror dhe vendor	Zbatuar	Rritja e integritetit publik
1.8	Angazhim për Standarte Open Contracting, publikim në formatin Open Data të kontratave publike	Pjesërisht i zbatuar	Rritja e integritetit publik, Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave
2.1	Zbatimi i Ligjit “Për mbrojtjen e Sinjalizuesve”, ngritje kapacitetesh dhe plotësim i akteve nënligjore	Zbatuar	Përmirësimi i shërbimeve publike, Rritja e integritetit publik, Rritja e përgjegjshmërisë së Korporatave, Krijimi i komuniteteve të sigurta

3.1	Ofrimi i shërbimeve elektronike	Zbatuar	Përmirësimi i shërbimeve publike
3.2	Krijimi i sistemit multifunksional të qendëruar për lejet e ndërtimit	Zbatuar	Përmirësimi i shërbimeve publike
3.3	Prezantimi dhe shtimi i sporteve digjitale	Zbatuar	Përmirësimi i shërbimeve publike, Rritja e integritetit publik
3.4	Standardizimi i Kartelës Informuese	Zbatim i konsiderueshëm	Rritja e integritetit publik
3.5	Karta e Qytetarit	Zbatim i konsiderueshëm	Përmirësimi i shërbimeve publike, Rritja e integritetit publik
3.6	Sistemi elektronik i regjistrimit të recetave elektronike në Republikën e Shqipërisë	Në proces	Përmirësimi i shërbimeve publike, Rritja e integritetit publik, Menaxhimi më efektiv i burimeve publike, Krijimi i komuniteteve të sigurta
4.1	Sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve	Zbatuar	Menaxhimi më efektiv i burimeve publike, Rritja e përgjegjshmërisë së Korportave
4.2	Sistemi elektronik i integruar për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit	Zbatuar	Përmirësimi i shërbimeve publike, Menaxhimi më efektiv i burimeve publike.

1. Përfundimet dhe mësimet e nxjerra

Nëpërmjet zbatimit të PKV të katërt të Shqipërisë, qeveria ka punuar për të forcuar dhe për promovuar një qeveri më efikase, transparente dhe të përgjegjshme. Qeveria shqiptare ka zbatuar plotësisht shumë nga angazhimet e synuara në këtë Plan Kombëtar Veprimi dhe ka bërë progres në zbatimin e angazhimeve të tjera.

Pesë rekomandimet kryesore ‘smart’ për vitin 2017 të Mekanizmit të Pavaruar të Raportimit, ishin si më poshtë vijon:

(burimi: Independent Reporting Mechanism (IRM) Progress Report 2016–17: Albania, https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Mid-Term_2016-2018_ALB_for-pub-comm.pdf)

Të sigurohet rinovimi i udhëheqjes dhe transferimi i njohurive institucionale mbi PQH-në.

Kuadri institucional i lidhur me zbatimin e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur në Shqipëri pësoi ndryshime pas zgjedhjeve të vitit 2017. Në kuadër të këtij ristrukturimi, institucioni i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MSHIAP) u shkri dhe Zëvendëskryeministri u caktua si Koordinator i ri Kombëtar në nivelin politik për PQH-në dhe Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri u caktua si sekretariat teknik për PQH-në.

Gjithashtu hartimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve të reja në kuadër të iniciativës për qeverisje të hapur do të kryhet në vijim nëpërmjet përdorimit të mekanizmit të menaxhimit të integruar të politikave. Kjo vendimmarrje do të sigurojë integrimin e PQH-së brenda kuadrit strategjik të politik-bërjes në vend dhe harmonizimin e tij me proceset kyçe të programimit buxhetor afatmesëm dhe planit kombëtar të integritit evropian. Ky strukturim do t’i japë përfundimisht zgjidhje problematikave të evidentuara në raportet e Mekanizmit të Pavaruar të Raportimit si: mungesa e buxhetit të dedikuar dhe burimeve njerëzore për PQH-në; nevoja për promovimin e përjasjes për qeverisje të hapur në zhvillimin e reformave kyçe sektoriale; nevoja që institucionet drejtuese dhe ato mbështetëse të marrin përsipër përgjegjësitë e angazhimeve; nevoja për rritjen e vizibilitetit të PQH-së brenda vendit;

Të respektohen Standardet e Pjesëmarrjes dhe Bashkë-Krijimit të PQH.

Lançimi i Forumit të Aktorëve të Interesit/OpenAlb, me një përfaqësim të barabartë të zyrtarëve qeveritarë dhe anëtarëve të shoqërisë civile, në Mars 2016 ishte një hap përpara i Shqipërisë për të përket respektimit të standardeve të pjesëmarrjes dhe bashkë-krijimit të PQH-se. Nëpërmjet këtij forumi u bashkërendua puna për propozimin dhe miratimin e angazhimeve të Planit të Tretë Kombëtar të Veprimit për PQH-në, ku katër prej angazhimeve të miratuara për herë të parë erdhën si propozim i organizatave të shoqërisë civile. Gjatë fazës së zbatimit të Planit të Veprimit ky forum u mbledh vetëm një herë, gjatë muajit nëntor 2016 dhe nuk e përmbushi dot funksionin e tij për monitorimin e zbatimit të angazhimeve të qeverisjes së hapur.

Në vlerësimin e Qeverisë Shqiptare, paçka arritjeve pozitive të tij, një mekanizëm i tillë “ad hoc” nuk mund të sigurojë qëndrueshmërinë e nevojshme për vijimësinë e iniciativës së Partneritetit për Qeverisjen e Hapur në Shqipëri dhe do jetë gjithmonë i “cënueshëm”, siç dhe u vërtetua, në rastin e ndryshimeve institucionale dhe udhëheqjes politike në vend.

Në këtë aspekt, përfshirja e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur brenda mekanizimit të integruar sektorial/ndërsektorial e vendos iniciativën brenda forumeve të konsoliduara të dialogut politik midis përfaqësuesve të qeverisë, partnerëve për zhvillim e integrim dhe shoqërisë civile.

Mbetet detyra e Qeverisë Shqiptare të sigurojë respektimin e standardit të pjesëmarrjes dhe bashkë-krijimit të PQH-së brenda strukturimit dhe funksionimit të Grupeve të Menaxhimit të Politikave të Integuara dhe Grupeve Tematike, dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme, nëse duhet brenda këtyre mekanizmave. Gjithashtu, Raporti i Vetëvlerësimit 2016-2018 është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Të vihet fokusi tek angazhime ambicioze me lidhje me vlerat PQH për sa i përket kontratave të hapura në përputhje me kuadrin e anëtarësimit në BE.

Angazhimi i Qeverisë Shqiptare për sa i përket kontratave të hapura është konkretizuar nëpërmjet zbatimit të angazhimit Nr.1.8 (referuar faqes 16).

Të sigurohet zbatimi me efektivitet i legjislacionit për konsultimin publik.

Megjithëse në PKV për PQH-në 2018-20 nuk janë përfshirë drejtpërdrejtë angazhime që lidhen me këtë prioritet, vlen të theksohet se është bërë progres për sa i përket zbatimit të legjislacionit për njoftimin dhe konsultimin publik. Çdo ministri linje tashmë ka caktuar një koordinator që ndjek procesin e konsultimit publik. Gjithashtu cilësia e akteve të konsultuara është rritur po ti referohemi raportit të SNRAP-it (87% për vitin 2017 dhe 90% për vitin 2018) dhe me mbështetjen e OECD/SIGMA po vijon puna për ndërtimin metodologjisë për përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi.

Të prioritetizohet deklarimi i pasurive të zyrtarëve dhe aksesit i publikut tek regjistri i tokës.

Megjithëse në PKV për PQH-në 2018-20 nuk janë përfshirë drejtpërdrejtë angazhime që lidhen me këto prioritete, duhet theksuar se është bërë progres për përgatitjen dhe ngritjen e sistemit elektronik të deklarimit të pasurive të zyrtarëve publikë. Në këtë aspekt është rishikuar kuadri ligjor dhe nën ligjor për të mundësuar ngritjen dhe vënien në funksionim të këtij sistemi, i cili po mbështetet nëpërmjet asistencës teknike dhe financiare të partnerëve ndërkombëtarë si Agjencia a Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Sistemi elektronik i deklarimit të interesave private të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik, do të jetë një mjet i rëndësishëm për rritjen e aftësisë investiguese dhe kontrolluese të ILDKPI-së ndaj kësaj kategorie zyrtarësh dhe do t'i mundësojë në të njëjtën kohë publikut, medias dhe shoqërisë civile konsultimin e hapur të këtyre deklaratave. Ky sistem pritet të jeta operativ brenda vitit 2019.

